

**V E N D I M**  
**Nr.98, datë 27.7.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |     |
|-----------------|--------------------------------|-----|
| Fehmi Abdiu     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |     |
| Zija Vuci       | Anëtar i                       | ''' |
| Gjergj Sauli    | Anëtar i                       | ''' |
| Alfred Karamuço | Anëtar i                       | ''' |
| Kristofor Peçi  | Anëtar i                       | ''' |
| Petrit Plloçi   | Anëtar i                       | ''' |
| Tefta Zaka      | Anëtare e                      | ''' |
| Sokol Sadushi   | Anëtar i                       | ''' |
| Kujtim Puto     | Anëtar i                       | ''' |

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 27.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.108 Akti që i përket:

**KËRKUES:** NDREKË RUKAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste në zonën zgjedhore nr.4, përfaqësuar me prokurë nga avokat Preng Zefi.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

- 1.KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. Valentin Palaj, përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben Ristani.
3. KOMISIONI i ZONËS ZGJEDHORE NR.4, përfaqësuar nga Njac Çapaliku.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimi i vendimit nr.200, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Në kërkesë janë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

1. Në të tre qendrat e votimit për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur përsëritjen e zgjedhjeve, zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe në përputhje me ligjin.
2. Në asnjë prej procesverbaleve të qendrave të votimit nuk janë pasqyruar vërejtje nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit apo përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuarit, subjektet e interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 200, datë 25.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4 dhe ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.7 të Komunës Velipojë (Reç) për kandidatin e drejtpërdrejtë dhe për subjektet politike, në qendrën e votimit nr.4 Barbullush dhe në qendrën e votimit nr.31 Pazar i Vjetër, vetëm për kandidatin e drejtpërdrejtë.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë. Në qendrën e votimit nr.7 Velipojë nuk është zhvilluar fare votimi për shkak se u ndryshua vendndodhja e komisionit të qendrës së votimit nga fshati Reç në fshatin Rrjollë, pa miratimin përkatës, si dhe për dobësi të tjera organizative. Në këtë mënyrë, nuk iu dha mundësia zgjedhësve për të votuar. Moskryerja fare e votimit ndikon edhe për numrin e votave në ndarjen e mandateve plotësuese (proporcionalit), gjë që imponon zhvillimin përsëri të zgjedhjeve si për kandidatët, ashtu edhe për subjektet elektorale.

Mosrespektim të ligjit dhe dobësi të tjera organizative pati edhe në qendrën e votimit nr.4

Barbullush ku vendndodhja e qendrës së votimit ishte ndryshuar natën pa miratimin e komisionit më të lartë zgjedhor dhe pa dijeninë e përfaqësuesit të subjektit elektoral të "Bashkimit për Fitore". Po kështu, në qendrën e votimit nr.31, fletët e votimit ishin të vulosura më parë nga anëtarët e komisionit dhe nuk u pranuan vëzhguesit e subjektit elektoral të Partisë Demokratike.

Të gjitha këto kanë ndikimin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve në zonë, prandaj duhet përsëritur votimi.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronjat "c", f", të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri

#### V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.